



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 72

Tiranë – E enjte, 23 prill 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 35/2020 datë 16.4.2020	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 4013
Dekret i Presidentit nr.11463, datë 22.4.2020	Për shpallje ligji..... 4014
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.113, datë 15.4.2020	Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme, modelin e autorizimit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte dhe modelin e autorizimit për eksportin e mbetjeve të rrezikshme..... 4014
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr.4828, datë 22.4.2020	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare..... 4023



LIGJ
Nr. 35/2020

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODI PENAL I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetesh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 130/a ndryshohet si më poshtë:

“Neni 130/a
Dhuna në familje

Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjahërr, vjahërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjahërr, vjahërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë

cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjahërr, vjahërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtira, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim.”.

Neni 2

Pas nenit 242 shtohet neni 242/a me këtë përmbajtje:

“Neni 242/a

Moszbatimi i masave të autoriteteve
shtetërore gjatë gjendjes së masave të
jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së
epidemisë

Moszbatimi ose kryerja e veprimeve në kundërshtim me aktet ligjore apo nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore, në funksion të gjendjes së epidemisë apo të zbatimit të masave të jashtëzakonshme, nga personi, ndaj të cilit është dhënë më parë masë administrative, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Po kjo vepër, kur është kryer në ushtrim të aktivitetit tregtar, duke vendosur në rrezik shëndetin e njerëzve, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Moszbatimi i urdhrit të dhënë nga organet kompetente për karantinim ose izolimin, apo shkelja e rregullave të karantinës ose të izolimit nga personi mbartës ose jo i sëmundjes infektive, të cilit i është njoftuar ky detyrim nga autoritetet shtetërore përkatëse, dënohet me burgim nga dy deri në tre vjet.”.



Neni 3

Pas nenit 89/a shtohet neni 89/b me këtë përmbajtje:

Neni 89/b

Përhapja e sëmundjeve infektive

Përhapja me dashje e sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin, nëpërmjet kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve nga personi që është diagnostikuar si mbartës i sëmundjes apo nga personi që ka qëllim përhapjen e saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër është kryer nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar pasojat të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën e njerëzve, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.4.2020

Shpallur me dekretin nr. 11463, datë 22.4.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr.11463, datë 22.4.2020

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr.35/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.”.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

URDHËR

Nr.113, datë 15.4.2020

**PËR MIRATIMIN E MODELIT TË
AUTORIZIMIT PËR EKSPORTIN E
MBETJEVE JO TË RREZIKSHME,
MODELIN E AUTORIZIMIT PËR
KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO TË
RREZIKSHME APO INERTE DHE
MODELIN E AUTORIZIMIT PËR
EKSPORTIN E MBETJEVE TË
RREZIKSHME**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 28 shkronja “d” të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar si dhe pikave 29 dhe 31 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 641, datë 1.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Miratimin e modelit të autorizimit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve të rrezikshme sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Urdhri nr.81, datë 21.3.2019 “Për miratimin e modelit të autorizimit për eksportin e mbetjeve jo të rrezikshme, modelin e autorizimit për kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme apo inerte dhe modelin e autorizimit për eksportin e mbetjeve të rrezikshme”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Blendi Klosi**



SHTOJCA 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 2880/ Prot.Tiranë, më: 15.09 2020**A U T O R I Z I M****PËR EKSPORTIN E MBETJEVE JO TË RREZIKSHME**

Në mbështetje të nenit 51 të ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar, miratohet ky autorizim për eksportin e mbetjeve si më poshtë:

1. Personi fizik/juridik “.....” autorizohet të eksportoje nga territori i Republikës së Shqipërisë mbetjet e llojit..... . Këto mbetje do të grumbullohen në ambientet e personit fizik/juridik “.....” në adresën..... dhe trajtimi i tyre përfundimtar do të realizohet në shtetin/et e (sipas destinacionit në pikën 3 më poshtë).

TË DHËNAT E PERSONIT FIZIK/JURIDIK:

Emri: “.....”

Adresa:

NIPT:.....

ADMINISTRATORI/PERSONI KONTAKTIT:

Emër Mbiemër:

Tel/Mob:

Email:.....

2. *Specifikimet për mbetjet që do të eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.*



<i>LLOJI I MBETJES</i>	<i>KODI SHIFROR</i>	<i>KODI SIPAS KONVENTËS SË BASELIT</i>	<i>KODI SIPAS KATALOGUT SHQIPTAR TË MBETJEVE</i>	<i>KODI SIPAS NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE</i>	<i>SASIA (TON/VIT OSE COPE)</i>	<i>GJENDJA FIZIKE</i>
.....	AL XYZ/viti kur lëshohet autorizimi					

3. *Rrugët që do të ndjekë mbetja dhe destinacioni përfundimtar i mbetjeve.*

<i>NR.</i>	<i>DEGA DOGANORE E DALJES</i>	<i>VENDI I DALJES</i>	<i>VENDI/ET TRANSIT</i>	<i>DEGA DOGANORE E HYRJES</i>	<i>VENDI I DESTINACIONIT</i>
1.					

4. *Masat e nevojshme që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.*

- Ambalazhimi që do përdoret për mbetjet (emërtimi i mbetjes) për shmangien e ndotjes së mjedisit është si më poshtë:

a.

b.

- Etiketimi i ambalazheve të mbetjeve, i kontenierëve dhe mjetit të transportit në një vend të dukshëm të jetë si më poshtë:

a. (Logo, përmasat) ose

b. e pa aplikueshme

- Trajnimi i punonjës/ve që do të realizojnë transportimin e mbetjeve (shoferat etj.) për rrezikun e mbetjeve, masat parandaluese dhe ato veprimet që do të ndërmerren në rast aksidenti.



- Rregjistrimi i sasive të mbetjeve që eksportohen dhe të dërgimi i informacionit zyrtar çdo 6 muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nga data e lëshimit të këtij autorizimi.

5. Afati i autorizimit të eksportit dhe përgjegjësitë ligjore.

1. Personi fizik/juridik “.....”mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr.10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe në VKM nr.641, date 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar, për eksportin e mbetjeve për të cilat lëshohet ky autorizim.
2. Transporti i mbetjeve që nga vendi i daljes deri në vendin e destinacionit nga personi fizik/juridik (emërtimi.....) duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë vijon: (dokumentacioni përcaktohet në varësi të llojit të mbetjes dhe qëllimit të eksportit për rikuperim/asgjësim):
 - c. Autorizimin për eksport origjinal ose kopje të noterizuar të tij;
 - d. Dokumentin e lëvizjes të plotësuar sipas Aneksit 2 të VKM nr. 641, datë 01.10.2014;
 - e. Informacionin sipas Aneksit 3 të VKM nr. 641, datë 01.10.2014.
3. Autorizimi i eksportit të mbetjeve të sipërcituara është i vlefshëm për një afat kohor deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit më ____/ ____/ ____ deri më ____/ ____/ ____.

MINISTËR

Blendi KLOSI



SHTOJCA 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 2880/2 Prot.Tiranë, më: 15.09 2020**A U T O R I Z I M****PËR KALIMIN TRANSIT TË MBETJEVE JO TË RREZIKSHME APO INERTE**

Në mbështetje të nenit 50 të ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, miratohet ky autorizim transitit sipas pikave të përcaktuar si më poshtë:

1. Personi fizik/juridik”.....” autorizohet të transitojë nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë mbetje të llojit

TË DHËNAT E PERSONIT FIZIK/JURIDIK:

Emri: “.....”

Adresa:

ADMINISTRATORI/PERSONI KONTAKTIT:

Emër Mbiemër:

Tel/Mob:

Email:.....

**2. SPECIFIKIMET PËR MBETJET QË DO TË TRANSITOHEN NËPËR
TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.**

LLOJI I MBETJES	KODI SHIFROR	KODI SIPAS KONVENTËS SË	KODI SIPAS	KODI SIPAS	SASIA (TON/VIT) <i>ose</i>	GJENDJA FIZIKE



		<i>BASELIT</i>	<i>KATALOGUT SHQIPTAR TË MBETJEVE</i>	<i>NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE</i>	<i>(COPË)</i>	
.....	AL XYZ/viti kur lëshohet autorizimi					

3. RRUGËT QË DO TË NDJEKË MBETJA/ET DHE DESTINACIONI PËRFUNDIMTAR I MBETJEVE.

<i>NR.</i>	<i>VENDI I DALJES</i>	<i>VENDI/VENDET TRANSIT</i>	<i>DEGA DOGANORE E HYRJES NË SHQIPËRI</i>	<i>DEGA DOGANORE E DALJES NGA SHQIPËRIA</i>	<i>VENDI I DESTINACIONIT</i>
1.					

4. MASAT E NEVOJSHME QË DUHET TË MERREN PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DHE SHËNDETIT TË NJERIUT.

- Ambalazhimi që do përdoret për mbetjet (emërtimi i mbetjes) për shmangien e ndotjes së mjedisit të jetë si më poshtë:

a.

b.

- Etiketimi i ambalazheve të mbetjeve, i kontenerëve dhe mjetit të transportit të jetë në një vend të dukshëm si më poshtë:

a. (Logo, përmasat) ose

b. e pa aplikueshme

5. AFATI I AUTORIZIMIT TË TRANSITIT DHE PËRGJEGJËSITË LIGJORE.



- Personi fizik/juridik “.....” mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr.10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe në VKM nr.641, date 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte” për transitimin e mbetjeve për të cilin lëshohet ky autorizim.
- Transporti i mbetjeve nga dega doganore e hyrjes në Republikën e Shqipërisë deri në degën doganore të daljes nga Republika e Shqipërisë duhet të shoqërohet me:
 - a. Autorizimin për transit origjinal ose kopje të noterizuar të tij;
 - b. Dokumentin e lëvizjes të plotësuar sipas Aneksit 2 të VKM nr. 641, datë 01.10.2014;
 - c. Informacionin sipas Aneksit 3 të VKM nr. 641, datë 01.10.2014.
- Autorizimi i transitit të mbetjeve të sipërcituara është i vlefshëm për një afat kohor deri në 1 (një) vit nga data e lëshimit më ____/ ____/ ____ deri më ____/ ____/ ____.

MINISTËR

Blendi KLOSI



SHTOJCA 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI

Nr. 2830/3 Prot.Tiranë, më: 15.04 2020**A U T O R I Z I M****PËR EKSPORTIN E MBETJEVE TË RREZIKSHME**

Në mbështetje të nenit 51 të ligjit Nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar dhe VKM nr. 641, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar, miratohet ky autorizim për eksportin e mbetjeve si më poshtë:

1. Personi fizik/juridik “.....”autorizohet të eksportoje nga territori i Republikës së Shqipërisë mbetjet e llojit..... . Këto mbetje do të grumbullohen në ambientet e personit fizik/juridik “.....” në adresën.....dhe trajtimi i tyre përfundimtar do të realizohet në shtetin/et e (sipas destinacionit në pikën 3 më poshtë).

TË DHËNAT E PERSONIT FIZIK/JURIDIK:

Emri: “.....”

Adresa:

NIPT:.....

ADMINISTRATORI/PERSONI KONTAKTIT:

Emër Mbiemër:

Tel/Mob:

Email:.....

2. *Specifikimet për mbetjet që do të eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë.*



<i>LLOJI I MBETJES</i>	<i>KODI SHIFROR</i>	<i>KODI SIPAS KONVENTËS SË BASELIT</i>	<i>KODI SIPAS KATALOGUT SHQIPTAR TË MBETJEVE</i>	<i>KODI SIPAS NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE</i>	<i>SASIA (TON/VITI OSE COPË)</i>	<i>GJENDJA FIZIKE</i>
.....	AL XYZ/viti kur lëshohet autorizimi					

3. *Rrugët që do të ndjekë mbetja dhe destinacioni përfundimtar i mbetjeve.*

<i>NR.</i>	<i>DEGA DOGANORE E DALJES</i>	<i>VENDI I DALJES</i>	<i>VENDI/ET TRANSIT</i>	<i>DEGA DOGANORE E HYRJES</i>	<i>VENDI I DESTINACIONIT</i>
1.					

4. *Masat e nevojshme që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.*

- Ambalazhimi që do përdoret për mbetjet (emërtimi i mbetjes) për shmangien e ndotjes së mjedisit është si më poshtë:

a.

b.

- Etiketimi i ambalazheve të mbetjeve, i kontenierëve dhe mjetit të transportit në një vend të dukshëm të jetë si më poshtë:

a. (Logo, përmasat) ose

b. e pa aplikueshme

- Trajnimi i punonjës/ve që do të realizojnë transportimin e mbetjeve (shoferat etj.) për rrezikun e mbetjeve, masat parandaluese dhe ato veprimet që do të ndërmerren në rast aksidenti.



- Rregjistrimi i sasive të mbetjeve që eksportohen dhe të dërgimi i informacionit zyrtar çdo 6 muaj në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, nga data e lëshimit të këtij autorizimi.

5. Afati i autorizimit të eksportit dhe përgjegjësitë ligjore.

1. Personi fizik/juridik “.....”mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr.10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe në VKM nr.641, date 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inerte”, të ndryshuar, për eksportin e mbetjeve për të cilat lëshohet ky autorizim.
2. Transporti i mbetjeve që nga vendi i daljes deri në vendin e destinacionit nga personi fizik/juridik (emërtimi.....) duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë vijon: (dokumentacioni përcaktohet në varësi të llojit të mbetjes dhe qëllimit të eksportit për rikuperim/asgjësim):
 - c. Autorizimin për eksport original ose kopje të noterizuar të tij;
 - d. Dokumentin e lëvizjes të plotësuar sipas Aneksit 2 të VKM nr. 641, datë 01.10.2014;
 - e. Informacionin sipas Aneksit 3 të VKM nr. 641, datë 01.10.2014.
3. Autorizimi i eksportit të mbetjeve të sipërcituara është i vlefshëm nga data e lëshimit më ____/ ____/ ____ deri në datën e miratimit të përcaktuar nga vendi pritës.

MINISTËR

Blendi KLOSI

NJOFIM

Nr.4828, datë 22.4.2020

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

“Protokolli ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian mbi ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar”, ka hyrë në fuqi më 27 janar 2020.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Armand Skapi**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë